

S T A T U T I

I shoqerise tregtare  
" CTC COMPUTER TRADE COMPANY SHPK "

1. KRYEJE

- 1.1 Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar " CTC COMPUTER TRADE COMPANY SHPK ", e cila qe ketu dhe me pas referohet si shoqeri, krijohet mbi bazen e iniciatives dhe kapitalit themeltar te ortakut te vetem :

Gene Laver Likoskendsaj, i datelindjes 16.2.1969, lindur ne Pier dhe banues ne Tirane.

- 1.2 Shoqeria krijohet dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e ketij statuti si dhe te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.
- 1.3 Kjo shoqeri, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, i perballon huqjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

2. OBJEKTI

Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jete zhvillimi i veprimtarise ne keto fusha :

- 2.1 Eksporti dhe importi si dhe tregtimi me shumice i te gjithe llojeve te mallrave.

2.2

Sherbiset e transportit te udhetareve dhe te mallrave brenda teritorit te Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

Financimet dhe transakcionet e ndryshme financiare.

Dhenia e konsulences dhe kryerja e sherbimeve te ndryshme.

2.5

Organizimi dhe prodhimi i mallrave artizanale.

2.6

Veprimtaria e shtypshkrimit.

2.7

Zhvillimi i kurseve te ndryshme ne fushen e informatikes, biznesit etj.

2.8

Veprimtaria turistike dhe veprimtaria e agjensise turistike.

2.9

Veprimtaria e agjensise se informacionit per shitblerje te pasurise se luejtshme dhe te paluejtshme.

2.10

Veprimtaria investuese ne sektore te ndryshem te ekonomise si ne ndertim, bujqesi etj.

3.

### EMRI, SELIA, TERITORI

3.1

Kjo shoqeri do te quhet :


" CTC COMPUTER TRADE COMPANY SHPK "

Shoqeria do te fitoje personalitetin juridik, qe nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

3.2

Shoqeria do te kete qendren e saj ne qytetin e Tiranes, ku do te zhvillohet aktiviteti i saj kryesor ekonomik.

3.3 Selia e shoqerise do te jete ne rrugen "Vaso Pasha"  
Pall. 1, Shk. 1, Ap. 7 Tirane.



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ekonomik  
ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise  
ai dhe jashte saj.

Ajo mund te krijoje dage ose perfaqesi te saj ne  
rrrothe te tjera te Shqiperise, ose jashte saj.

4. KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

4.1 Kapitali themeltar i shoqerise do te perbehet nga  
kontributi i ortakut te vetem ne shumen 100 000 leke.

4.2 Kapitali themeltar do te deponohet ne nje banke te  
qytetit te Tiranes, para fillimit te aktivitetit te saj.

4.3 Kapitali themeltar mund te shtohet ose te zvogelohet  
deri ne kufijte ligjor, ne varesi te rezultateve dhe  
ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ai mund te  
shtohet edhe nepermjet kontributeve ne natyre.

4.4 Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise  
ose te lihet peng ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

4.5 Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem ne  
rruge trashegimie. Bashkeshortja, paraardhesit dhe  
pasardhesit mund te behen ortak, nepermjet transferimit  
te pjeseve te kapitalit themeltar, me vendim te ortakut  
te vetem dhe sipas kushteve te parashikuara ne ligj.

4.6 Kapitali themeltar mund te shtohet dhe me ane te  
pranimi te ortakëve te tjere me vendim te ortakut te  
vetem.

4.7 Me kontribute ne natyre do te kuptohen te gjithë makinerite e pajisjes si dhe sendet e palucjteshme qe kalojne ne pronesi te shoqerise etj.

4.8 Kapitulli themeltar ndahet ne pjese te barabarta me vlere 1 000 leke.

## 5. FONDET E SHOQERISE

5.1 Shoqeria percakton fondet e meposhtme :

1. Fondin qarkullues.
2. Fondin reserve
3. Fonde te tjera, te cilat mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

5.2 Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohen me vendim te organit drejtues te shoqerise.

## 6. ORGANI DREJTUES DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

6.1 Si organ i vetem drejtues i shoqerise eshte administratori qe eshte dhe president i shoqerise. Administrator i shoqerise, eshte ortaku i vetem, me inisiativen e kapitalin e te cilit, krijohet shoqeria.

6.2 E gjithë vepristaria e shoqerise percaktohet nga administratori i saj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

6.3 Per administrimin e shoqerise, ose te aktiviteteve te vesanta te saj, administratori - president i shoqerise, mund te emeroje nje ose administratore te tjere.

- 6.4 Kompetencat e administratorëve të tjere të mundshëm, përcaktohen nënën 8 të këtij statuti. Kompetencat konkrete dhe të detajuara të tyre përcaktohen në aktin e tyre të emerimit.



Shoqëria nuk merr përsipër veprimet e ndryshme që mund të kryejë administratori i mundshëm ( jo administratori - president ) në marrëdhënie me të tretet, të cilat i tejkalojnë kompetencat e tyre të përcaktuara në këtë statut dhe të detajuara në aktin e emerimit.

- 6.6 Administratori - presidenti, për të shqyrtuar bilancin vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe menyrën e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabile, emëron një ose disa eksperte kontabel për një periudhë prej gjashtë vjetesh financiare. Emerimi i ekspertit kontabel është i detyrueshëm në rastet e parashikuara në ligj.

7

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT - PRESIDENT

Për sa kohë që shoqëria do të përbehet nga një ortak i vetëm, kompetencat e administratorit - president do të jenë :

- 7.1 Vëndos për ndryshimet në statutin e shoqërisë dhe miraton rregulloret për sektoret e vecante të veprimtarisë së saj.
- 7.2 Vëndos për politiken afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
- 7.3 Emëron dhe shkarkon administratorët e tjere të mundshëm të shoqërisë dhe detajon kompetencat e tyre në aktin e emerimit.

- 7.4 Shqyrton bilanciin vjetor, kuotat e fondeve te ndryshme dhe fitimin e realizuar.
- 7.5 Vendet per krijimin e degeve ose te perfaqesive si per krijimin e shoqerive ose te ndërmarrjeve te perbashketa.
- 7.6 Vendet per shaderrimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kafizuar ne shoqeri te llojeve te tjera.
- 7.7 Vendet per marrjen e kredive si dhe per mbarimin e shoqerise nese ne dokumentet financiare, rezultatet e shoqerise vleresohen ne humbje.
- 7.8 Realizon ose miraton marrëdhëniet me te rendesishme ekonomike e financiare te shoqerise me persona te tjere juridike dhe fizike, te vendit ose te huaj.
- 7.9 Realizon ose miraton cimet e shitjes, te shërbimeve etj.
- 7.10 Vendet per pagat e personelit te punesuar ne shoqeri.
- 7.11 Vec kompetencave te lartepërmendura, te cilat jane ekskluzive per te, presidenti - administrator, ne rastet kur nuk ka emeruar administratore te tjere te mundshem, kryhen dhe kompetencat qe ne kete statut jane percaktuar per kete te fundit.

8. KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE TE TJERE TE MUNDSHEM

Kompetencat e administratoreve te tjere te mundshem, ne menyre konkrete e te detajuar, percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Vec te tjerave, qe mund te detajohen ne kete akt, administratori tjetër i mundshem ka edhe keto kompetenca :

- 8.1 Kujdeset per funksionimin e perditeshem dhe normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj.
- 8.2 Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise dhe ia paraqet per shqyrtim administratorit - president.
- 8.3 Koordinon veprimtarine e personelit te punesuar ne shoqeri.
- 8.4 Shqyrton oferta dhe pergatit kontrata, te cilat ia paraqet administratorit - president per miratim.
- 8.5 Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet e ndryshme shteterore, ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- 8.6 I propozon administratorit - president, cmimet e shitjes, te sherbimeve etj si dhe pagat e personelit te punesuar ne shoqeri.
- 8.7 I propozon presidentit rregulloret per sektore te vecante te veprimtarise se shoqerise.

9. MEMBRA E PERSOENESIMIT

Shoqeria perfaqesohet nga administratori - president i saj ne te gjitha marredheniet e ndryshme juridiko-civile me persona te tjere juridike dhe fizike. Ajo mund te perfaqesohet edhe nga administratori tjeter i mundshem ose nga ndonje person tjeter, i cili duhet te jete i pajisur me autorizim te vecante.

10. FITIMI

10.1 Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme, pagave te punonjesve, ortakut te vetem i mbetet ne dispozicion fitimi neto.

10.2 Fitimi neto mund te perdoret per zgjerimin e kapitalit themelitar dhe te fondeve te shoqerise.

10.3 Fitimi neto mund te perdoret edhe per qellime te tjera.

11. KOMEZGJARJA E SHOQERISE

Kjo shoqeri krijohet per nje periudhe mbi 15 vjecare.

12. MANDATET E PUNESIMIT

Çdo person, duke perfshire dhe administratorin tjeter te mundshem, do te punesohet ne shoqeri mbi bazen e kontrates se punes te lidhur nderajet tij dhe administratorit - president te shoqerise, ne perputhje me legjislacionin e punes neftqi.

13. PERGJEGJESIA E PUNONJESVE DHE KONFIDENCIALITETI

Çdo person i caktuar si administrator tjeter i mundshem, ose i punesuar ne shoqeri, eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbushë detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes si dhe nga vendimet e administratorit - president. Ai eshte gjithashtu i detyruar te ruaje karakterin e fenehte te dokumentacionit, te informacionit, te pervojës se shkëmbyer si dhe te cdo lloj materiali tjeter konfidencial.



14. MBARIMI I SHOQERISE

14.1 Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit te saj drejtues, ne rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurese, per shkak te forces madhore, si dhe per shkaqe te tjera ligjore.

14.2 Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit neperajet formave te thithjes dhe te bashkimit.

14.3 Gjate fazes se likuidimit te shoqerise, administratori - president, administratori tjetër i mundshem si dhe eksperti kontabel kane te njejten pergjegjesi.  
Procedura e likuidimit zhvillohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

15. DISPOZITA TE PUNDT

15.1 Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Shjeter

15.2 Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne INSIS.

15.3 Shoqeria do te kete valen e saj, forma dhe madhesia e se ciles percaktohen nga administratori - president. para fillimit te aktivitetit te shoqerise.

Ky statut u miratua nga une, ortakut i vetem dhe administrator - president i shoqerise, sot me date 10. 12. 1993

ADMINISTRATORI

GENC LAYER LIKOSKANDAJ